



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 28.06.2018 dhe 02.07.2018.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”.
5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.
6. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.
7. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Evis Kushi, Klajda Gjoshaj, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Nard Ndoka, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Rudina Hajdari, Klevis Balliu dhe Edi Paloka.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë

Elida Petoshati – Drejtoreshë e Rajonit dhe Vendeve Fqinje në Ministrinë për Europën dhe Punët me Jashtë

Armand Skapi – Drejtor i Traktateve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Ministrinë për Europën dhe Punët me Jashtë

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Luljeta Dauti – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Bashkim Kasaruho – Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Lirika Radovicka – Përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Denada Seferi – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ermir Omari – Menaxher projektsh pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë sot mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 12.07.2018. Në rendin e ditës, përtej miratimit të procesverbaleve të datave 28 qershor dhe 2 korrik, që besoj dhe shpresoj se miratohen me mirëkuptim, kemi diskutimin e disa projektligjeve. Po i listoj: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”. Jam saktë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për diskutimin e këtij projektligji të ftuar nga Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë kemi: zotin Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm, zonjën Petoshati, drejtoreshë e Rajonit dhe Vendeve Fqinje, si dhe zotin Skapi, drejtor i Traktateve dhe Marrëveshje Ndërkombëtare.

Fjala është për ju, zoti Barbullushi.

Gazmend Barbullushi – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuara zonja e zotërinj deputetë,

Në përfaqësim të Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë, bashkë me kolegët e mi jemi këtu për të paraqitur para jush projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.

Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e rregullave të funksionimit të këtij organizmi ndërkombëtar, që do ta ketë selinë në vendin tonë, statusin ligjor dhe privilegjet e imunitetet e stafit.

Me krijimin e një fondi të përbashkët, arritur me marrëveshjen “Për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor” në Pragë, më 13.11.2015, synohet, së pari, afrimi ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe, së dyti, realizimi konkret i këtij bashkëpunimi nëpërmjet financimit të projekteve të vogla e të mesme në fushat, si: arsimit, kultura, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mjedisi, bashkëpunimi ndërkufitar e të tjerë.

Themelimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor është bërë në përputhje me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku Shqipëria angazhohet për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Marrëveshja që paraqesim sot me vendin pritës ndihmon dhe mundëson vazhdimin e implementimit të marrëveshjes kuadër për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Në bindjen tonë, pranimi nga vendet anëtare të këtij organizmi për vendosjen e selisë së Fondit në Tiranë dhe zgjedhjen e drejtorit të parë ekzekutiv nga Shqipëria, tregon për kontributin dhe rolin konstruktiv që ka luajtur dhe luan Shqipëria në rajon, kurorëzon përpjekjet tona dhe përbën një sukses të politikës sonë të jashtme. Deri sot asnjë nismë rajonale nuk ka pasur qendrën e saj në Shqipëri. Do të pasohet me qendra të Unionit. Të dyja janë produkt i procesit të integritetit evropian.

Për sa i takon ligjshmërisë dhe përmbajtjes së marrëveshjes, projektligji është në përputhje me pikën 1 të nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjen për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënshkruar në Pragë, më 13.11.2015, hyrë në fuqi më 25.05.2017, dhe me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.156, datë 21.03.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar në Tiranë, më 19.04.2018. Marrëveshja bazohet në Statutin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, i cili është pjesë e marrëveshjes kryesore kuadër për themelimin e këtij Fondi.

Duhet të futem më në detaje?

Mimi Kodheli – Unë mendoj të kalojmë te pyetjet nga kolegët, ju pastaj mund të hyni në detaje.

Gazmend Barbullushi – Institucioni që ngarkohet me zbatimin e kësaj marrëveshjeje është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, prandaj edhe ne jemi sot këtu.

Për sa u takon shpenzimeve financiare, zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte të drejtpërdrejta financiare nga pikëpamja buxhetore, pasi ambienti ku është vendosur sekretariati i Fondit është ofruar pa pagesë për një periudhë 5- vjeçare, bërë në zbatim të marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, dhe është pronë e shtetit shqiptar.

Mund të ketë efekte financiare, që kanë të bëjnë me përjashtimin e...

Mimi Kodheli – E TVSH-së?

Gazmend Barbullushi – Po, TVSH-së për diplomatët, sepse do të kenë statusin e diplomatit.

Këto janë çfarë ne paraqitëm këtu. Nuk janë në një nivel të atillë, shumë më tepër është impakti politik që ne publikojmë dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri.

Duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj, shprehemi të hapur për çdo pyetje që mund të keni!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Unë mendoj se jemi pikërisht në momentin e duhur që marrëveshja e Berlinit të mund të konkretizohet dhe të fillojë të veprojë si një marrëveshje aktive dhe jo të mbetet në letër. Ndaj ju përgëzoj për punën dhe sjelljen e këtij projektligji këtu.

Nëse ka pyetje ose komente, fjala është ju.

(Deputetja Gjoshë kërkon fjalën.)

Jo, fillimisht do ta marrë fjalën deputetja Kushi.

Klajda Gjoshë – Si të dëshironi.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kam një pyetje që lidhen me nenet 2 dhe 5 të projektligjit.

Për sa i takon nenit 2, siç e theksuat edhe ju, vendi pritës do t'i sigurojë Fondit, pa pagesë, objektet e nevojshme dhe hapësirat e duhura, pajisje, orendi e të tjera për pesë vjetët e parë, pas themelimit të Fondit. Çfarë do të ndodhë pas këtyre pesë vjetëve?

Gazmend Barbullushi – Praktikisht, edhe vitin pasardhës do ta shohim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Kjo ishte pyetja e parë, pra si?

Gazmend Barbullushi – Domethënë, nuk kemi ndonjë mekanizëm të caktuar aty. Kjo është praktikë normale edhe në vendet e tjera, që para përfundimit të këtij afati ne do të hyjmë në diskutim edhe me vendet anëtare të këtij organizmi se si do të vazhdohet më tej, por të paktën për pesë vjet e kemi siguruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Domethënë, kjo çështje do të diskutohet kur të vijë ai moment.

Gazmend Barbullushi – Kur të kalojë viti i katërt do të vijojmë me diskutimet me vendet anëtare dhe sekretariatën se si mund të vazhdojë, qoftë edhe me vendet që na kanë ndihmuar me donacione.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Pyetja ime e dytë lidhet me nenin 5. Në pikën 8 të këtij neni thuhet: “Për sa i përket tatimit mbi vlerën e shtuar të përfshirë në çmime ose të faturuara veçmas, përjashtimi do të zbatohet vetëm për sasi të arsyeshme të artikujve të blerë dhe shërbimeve të bëra...” e të tjera. Më shqetëson disi shprehja “për sasi të arsyeshme”, pra si do të matet, sepse duket paksa subjektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazmend Barbullushi – Faleminderit për pyetjen!

Kjo është terminologji e përdorur edhe në praktikën e mëparshme të marrëveshjeve të ngjashme për vendosjen e selisë së organizatave ndërkombëtare në kryeqytete të ndryshme. Lidhur me sasi të arsyeshme nuk mund të bëjmë një përcaktim 100% se sa do të jenë blerjet apo shpenzimet e një organizmi të tillë rajonal me seli në Shqipëri.

Kur themi “sasi të arsyeshme” e nënkuptojmë brenda logjikës së funksionimit të një selie të një organizmi rajonal.

Evis Kushi – Kam merakun se le hapësira për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, dikujt i duket e arsyeshme, dikujt jo. Është paksa e vështirë që...

Gazmend Barbullushi – Këto vlerësohen nga institucionet që merren me rimbursimin e TVSH-së, konkretisht nga Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë, e cila ka një eksperiencë shumë të gjatë me përfaqësitë e huaja, që kanë selitë në Shqipëri. Kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo çështje është diskutuar edhe me vetë Fondin, por është një formulim i përgjithshëm, i cili nuk mund të krijojë barrierë ose tavane dhe dyshme të precizuara, sepse nuk i dimë realisht, por do të jetë brenda logjikës normale të funksionimit të një zyre prej 15 vetash aktualisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjoshë.

Klajda Gjoshë – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë që janë sot këtu për këtë projektligj!

Në fakt, sot diskutohet një mekanizëm shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë pikërisht me Procesin e Berlinit, i cili jo vetëm e ndihmon këtë proces, por u vjen në ndihmë edhe vendeve, si Shqipëria dhe të gjithë rajonit, për të përfituar sa më shumë fonde bazuar mbi projektet konkrete, për të cilat ne duhet të jemi të gatshëm dhe të kemi kapacitetet e duhura për t’i paraqitur.

Pyetjet e mia shkojnë për projektet që ka Shqipëria këtë vit për t’i paraqitur Fondit të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit dhe si është ecuria e projekteve, të cilat janë fituar deri në këto momente në kuadër të këtij procesi.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zonja Petoshati.

Elida Petoshati – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare, për vlerësimin dhe pyetjen!

Siç edhe ju e evidentuat, janë një sërë projektesh ku Shqipëria jo vetëm si vend pritës, por edhe si pjesëmarrëse aktive në Fondin e Ballkanit Perëndimor ka aplikuar.

Projektet e para u lançuan në nëntor të vitit të kaluar dhe praktikisht ka filluar implementimi i tyre, konkretisht në muajt prill-maj. Janë rreth 18 projekte që janë fituar nga organizatat e shoqërisë civile shqiptare, të cilat janë të bashkërenduara *bet to bet* me disa shoqata të shoqërisë civile të vendeve të rajonit, sepse ky është edhe impakti që këto projekte duhet të sjellin: një impakt ndërrajonal që forcon urat e njohjes, por që prek edhe ato aspekte që nxisin bashkëpunimin rajonal dhe nevojat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Praktikisht ne kemi qenë në pararojë për disa projekte, që kanë të bëjnë me fuqizimin e grave dhe të vajzave, po ashtu me aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm, me aspektet mjedisore, bashkëpunimin ekonomik, por shoqatat tona kanë paraqitur konkretisht këto projekte dhe janë vlerësuar si projekte fituese, me aspekt barazinë gjinore.

Klajda Gjoshë – Mundem, në përgjigje të..?

Mimi Kodheli – Po, urdhëroni.

Klajda Gjoshë – Faleminderit për përgjigjen!

Unë nuk e vë në diskutim që aspekti i barazisë gjinore është me shumë rëndësi, por mendoj se ky është një Fond, i cili duhet vënë më shumë në punë për sa i përket bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve, sepse, në fakt, ai shkon në kuadër të plotë me Procesin e Berlinit. Ndoshta edhe shoqëria civile këtu kërkon një tagër më të mirë të fokusimit të programeve ose të tematikave me të cilat duhet të paraqitet për t'i përthithur këto fonde, sepse vërtet Shqipëria ka përfituar fonde, por niveli i përfitimit nuk ka qenë ai i duhuri.

Unë besoj se këtu lë për të dëshiruar edhe mënyra se si shkruhen apo se si paraqiten projektet, kapacitetet që ne kemi edhe brenda institucioneve, por edhe nga shoqëria civile. Madje mendoj se duhet bërë edhe një trajnim më i mirë për sa i përket Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë, në kuadër të paraqitjes së projekteve nga shoqëria civile dhe nga institucionet, sepse fondi realisht duhet të shkojë aty ku me të vërtetë mund të ndihmojë urat lidhëse ndërmjet vendeve tona. Pra, besoj se drejtimi i duhur duhet të jetë drejt zhvillimit ekonomik.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë dua ta falënderoj ekipin e Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë edhe për prezantimin, edhe për punën e bërë, në fakt, se hapja e kësaj zyre në Shqipëri, posaçërisht në Tiranë është një arritje! Madje mendoj se duhet t'i japim më shumë hov rolit që Shqipëria ka për sa i përket bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor dhe në zhvillimin ekonomik e social të këtij rajoni.

Lidhur me çfarë tha kolegja Gjoshë, edhe unë jam e shqetësuar, në fakt, që një pjesë e fondeve të ardhura nga Bashkimi European nuk ka aftësi përthithëse jo vetëm në Shqipëri, por në përgjithësi në rajonin e Ballkanit Perëndimor, madje edhe më gjerë.

Dua të di, e para, a ka një strategji për ndarjen e informacionit lidhur me projektet e mundshme apo fushat që do të kërkojnë projekte, për të cilat BE-ja do të japë mbështetje nëpërmjet këtij Fondi? A keni mundësi trajnuese, informuese apo edhe ndihmëse qoftë për bashkitë, OJF-të apo institucionet e administratës publike për rritjen e këtyre kapaciteteve, në mënyrë që këto aftësi përthithëse të fondeve të rriten që projektet të përfitohen maksimalisht nga ky Fond të paktën për ne? Pra, të kemi ne një strategji tonën brenda vendit tonë që vërtet të synojmë marrjen mundësisht maksimale të këtyre fondeve.

E kam edhe për të ardhmen, jo thjesht lidhur me hapjen e zyrës në Tiranë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në mos gaboj, kemi diskutuar para disa kohësh, për *IPA Adriatic* edhe këtu, edhe te komisioni tjetër, ndaj e kam me merak faktin që ne, si deputetë, përveç faktit që ju e nxirrni në faqen tuaj të internetit, të marrin informacion për zonat që ne përfaqësojmë, sepse mund të jemi një urë lidhëse për bashkitë që ta marrin informacionin në kohën e duhur, të rrisin kapacitetet e tyre për të hartuar një projekt dhe mundësisht të aplikojnë suksesshëm për këto fonde, që dalin në faqen e internetit, por jo gjithmonë bashkitë i ndjekin.

Edhe për universitetet kam të njëjtin shqetësim. Jo gjithmonë ato janë të informuara për projektet që dalin, me qëllim që të kenë mundësi t'i përthithin fondet.

Faleminderit!

Mimi Kodheli –Faleminderit!

Elida Petoshati- Vëzhgimet tuaja mbahen shënim. Rritja e kapaciteteve dhe e njohjes për thithjen e fondeve normalisht është shumë e mirëpritur, sepse rrit fizibilitetin dhe ndërgjegjëson të gjithë aktorët që kërkojnë të jenë pjesëmarrës në projekte. Sekretariati i Fondit të Ballkanit Perëndimor ka nisur një strategji lobimi për të fuqizuar çuarjen e lajmit mbi mënyrat e të shkruarit të tyre, që të kenë sa më shumë impakt siç u evidentua edhe për bashkëpunimin ekonomik. Në Ministrinë e Jashtme edhe ato nukla që janë të lidhura me

tërheqjen e fondeve apo me projektet rajonale, janë të ndërgjegjësuar për të rritur më shumë fizibilitetin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Nëse nuk ka ndonjë pyetje apo koment tjetër, unë mendoj të kalojmë në votim.

Kush është dakord që të miratojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”? Kundër? Nuk ka. Neni 2 është hyrja në fuqi pas 15 ditëve.

Edhe njëherë ju kërkoj miratimin e nenit 1 dhe 2 dhe në tërësi të këtij projektligji.

Faleminderit!

Unë besoj se ju do të vazhdoni të rrini edhe për ...?

Elida Petoshati – Jo, jo

Mimi Kodheli – Kemi mbaruar me ju.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Mimi Kodheli – Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

(Diskutime pa mikrofon)

Të ftuar për ta paraqitur projektligjin ...

(Diskutime pa mikrofon)

Do të diskutoni ju si ministri e Financave fillimisht, apo vetëm ju?

(Diskutime pa mikrofon)

Është zonja Kospiri?

Mirë se keni ardhur, zonja Kospiri! Mirë se keni ardhur, zoti zëvendësministër!

(Diskutime pa mikrofon)

Fjala është për ju.

Erion Luçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa i përket projektit të prezantuar për arsimin profesional, kjo është një kredi e vogël në krahasim me realizimin e reformës së arsimit profesional, por edhe shumë aktiviteteve që arsimi profesional ka parashikuar brenda strategjisë së përmirësimit të rritjes së kapaciteteve të fushave të arsimit profesional.

Pa i hyrë strategjisë që është sjellë disa herë në parlament dua të theksoj se plani i kësaj kredie është bërë me mirëkuptimin e partnerëve tanë italianë. Ka si qëllim ngritjen e qendrave multifunksionale në Fier dhe një shkollë teknike në Lushnjë. Kurrikula për arsimin profesional, përmirësimin e kurrikulave në nivelin e arsimit të mesëm, kurset afatshkurtra dhe post funksionale.

Një komponent tjetër është ndihma në futjen e sistemit të huaj të ndërlidhjes së qendrave multifunksionale me sektorin privat.

Një komponent tjetër është konferenca me financimin e IPA2 për sektorin e punësimit dhe aftësive. Kjo është brenda strategjisë dhe mbështetjeje buxhetore për sektorin e arsimit profesional dhe aftësive, që kemi disa kohë që jemi duke e menaxhuar me Bashkimin Europian. Së fundmi pati edhe një rishikim të arritjeve. Është lajm pozitiv që rreth 95% e objektivave janë realizuar. Kështu që, është një program relativisht i suksesshëm deri në këtë pikë.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Luçi!

Kam një koment.

Pak ditë më parë, në komision diskutuam dy projektligje, që kishin të bënin me abortimin për shkak të mosrealizimit të dy projekteve të qeverisë shqiptare me efekte financiare të huaja lidhur me dy projekte të cilat do të kalonin nga projekte të përcaktuara në projekte të tjera. Përgjithësisht projektet kishin qenë të fokusuar në fushën e energjisë dhe tani do të kalonin në fushën e bujqësisë.

Nuk dua të bëj negativen dhe as të prezumoj gjëra të paqena. Me të drejtë në relacion ju thoni se duhet të ketë rezultate të pritshme. A ka dënim nëse njëra nga palët që lidh këto marrëveshje do të ketë dështime në kohë apo në cilësi të këtyre projekteve? Cila do të jetë mënyra e vlerësimit të skedulimit të marrëveshjes dhe si do të ndahen përgjegjësitë, sepse shpeshherë ne përballemi me këtë fenomen? Vjen fundi i vitit dhe nxitojmë që shumë para të pashpenzuara në një sektor, që mund të jetë faji i shumëkujt të tentojmë ti kalojmë në një tjetër. Në rastin e sektorit të energjisë, mendoj që faji ishte i mungesës së një studimi fizibiliteti të saktë lidhur me mundësinë apo pamundësinë e shqiptarëve, bizneseve shqiptare për të adresuar investimet e tyre në energji alternative, që lidhet me kulturën që shqiptarët kanë për këtë gjë apo me shumë arsye të tjera: pamundësinë për të vënë një pasuri në bankë apo për të garantuar investimin në banka e kështu me radhë.

Pra, po kalojmë te ky projekt. Nuk kemi asnjë problem me projektin apo me paratë që të tjerët sjellin pa interes, përkundrazi, (kjo është një gjë që ndodh rrallë dhe shumë mirë që

ndodh në rastin e Shqipërisë), por ne si ligjbërës do të kishim dashur garanci më të mëdha që këto projekte të realizohen, dhe do të realizohen në kohë, në mënyrë që në fund të vitit, projektit apo ditës, paratë të shpenzohen mirë dhe qytetarët shqiptarë të përfitojnë nga grante apo kredi, të cilat shteti mundohet t'i menaxhojë nëpërmjet ministrisë suaj, por që në fund të ditës duhet të kemi rezultat.

Keni ndonjë koment për komentin tim?

Bashkim Kasoraho - Shmangia e planifikimit fillestar është një paralele shumë e rëndësishme për financat publike. Duhet të jetë jo më e lartë se 5% nëse mund të vendosim dhe nëse përgjithësisht e tejkalojmë. Kjo tregon që problemi është përmirësuar vitet e fundit dhe pikërisht për shkak të protokollit të hapur që është përdorur gjatë qeverisjes në mandatin e kaluar dhe ka filluar të përmirësohet, nga shtrëngimi i planifikimit që shumë prej kolegëve tujë kemi punuar së bashku. Nga shërbimi i planifikimit deri te ekzekutivi është një proces që do të ishte kohë e vetë dhe është relativisht i gjatë.

Një nga elementet kyçe është forcimi i strukturave të auditimit, të cilat shkojnë te këto risqe dhe minimizimi i kostove të panevojshme që mund të dalin gjatë rrugës nëpërmjet këtyre vonësive. Projektet e huaja, edhe nga një analizë e fundit që kemi bërë, shpesh kalojnë 10 vjet, me një mesatare nga 5 deri në 10 vite që të krijohen do të prezantojmë sot, do të jenë projekte që mund të jemi në kohë.

Relativisht janë modeste për të justifikuar pjesën e termave të kushteve por kryesisht është efektiviteti dhe marrja në kohë e rezultatit brenda kohës së parashikuar. Përpjekja në këtë drejtim është shumë e madhe. Rezultati deri tani është relativisht premtues dhe puna mbetet për ta kompaktësuar më shumë atë. Shpresoj se në pikëpamje të modernizimit të financave publike, do të mbetet (të paktën edhe nga bisedat që patëm me pjesën e komisionit), një nga fushat me fokusin kryesor siç është drejtësia, për ta forcuar më tej, sepse është një kriter hyrje shumë i rëndësishëm. Edhe tani që po flasim, po marrim një asistencë të gjerë në këtë drejtim.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kush ka pyetje, komente?

Urdhëroni zonja Kushi!

Evis Kushi – Faleminderit, kryetare!

Edhe unë e vlerësoj shumë pozitivisht këtë projektligj, sepse një nga prioritetet e qeverisë është pikërisht arsimi dhe formimi profesional. Unë kam 2 pyetje, të cilat më lindën

duke lexuar relacionin e këtij projektligji, të cilat kanë lidhje me rezultatet e pritshme të programit.

E para, këtu thuhet që aktivitetet e detajuara për çdo rezultat, do të përfshijnë ndërhyrje fizike dhe jofizike, që mund të përmbliidhen në 4 komponentët e mëposhtëm:

1. Rehabilitimi i infrastrukturës;
2. Blerje mallrash;
3. Asistencë institucionale teknike;
4. Asistencë për ministrinë e linjës.

Çfarë nënkupton konkretisht komponenti i fundit, asistenca për ministrinë e linjës, që përfshihet tek ky projekt?

Pyetja e dytë: një nga rezultatet e pritshme është edhe zhvillimi i kurrikulave të arsimit dhe të formimit profesional, të orientuara nga tregu i punës. Unë kam një pyetje në lidhje me këtë projektligj dhe në përgjithësi me kurrikulat e shkollave të arsimit profesional apo me qendrat e formimit profesional. Këto kurrikula kalojnë për t'u miratuar nga Ministria e Arsimit, apo për qendrat dhe shkollat e formimit profesional, bëhet gjithçka vetëm në ministrinë tuaj?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ndërkohë që ju, zoti Luçi, përgatiteni, zonja Gjermani ka një pyetje për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë e gjej me shumë vend këtë projektligj dhe mendoj se do të ndikojë në formimin profesional, duke sjellë më shumë punësim.

Kam një pyetje lidhur me përzgjedhjen e shkollave bujqësore të Fierit dhe të Lushnjës që ju keni bërë këtu. Shumë mirë që i keni përzgjedhur! Unë nuk kam arsye ta paragjykoj këtë zgjedhje, por doja të dija se mbi ç'bazë është bërë kjo zgjedhje, nëse vërtet keni një studim që këto shkolla krijojnë ato profesione, që do të nxisin më shumë punësimin në këto zona dhe a ka zona të tjera, të cilat kanë nevojë dhe ju nuk arrini t'i mbulonit me këtë ligj, apo keni bërë një përzgjedhje mbi bazën e arsyeve specifike, sepse në varësi të shkollave profesionale, për shembull, në zonën, që unë përfaqësoj, në bashkinë e Krujës, e cila ka shumë turistë, ka nevojë për shërbime për turizmin, nuk ka asnjë shkollë profesionale. Prandaj po ju pyes, nëse vërtet përzgjedhja që ju bëni, bazohet në kërkesat që ka tregu, në shkolla ekzistuese, apo në një rajon të caktuar, që mund të ketë ndjeshmëri për punësimin apo për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – A mund të bëhet edhe një pyetje tjetër dhe pastaj të përgjigjeni për të gjitha pyetjet?

Erjon Luçi – Po.

Mimi Kodheli – Urdhëroni!

Elona Hoxha – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Kam një pyetje në lidhje me pikën “b”, ku thuhet se përzgjedhja dhe përgatitja do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, që ka një perspektivë më të gjerë për orientimin e tregut.

Nëse mund të na thoni, se çfarë nënkuptoni me këtë bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti zëvendësministër, fjala për ju!

Erjon Luçi – Për sa i përket asistencës teknike të konsulentit, kjo është kryesisht e lidhur me ndihmën që do t’i jepet pjesës së politikëbërjes, që është e lidhur me vlerësimin e strategjisë për sa u përket politikave të arsimit profesional. Ka një shumë relativisht të vogël, në krahasim me pjesën tjetër që është rreth 116 mijë euro.

Kjo është për asistencë për personelin mësimdhënës dhe do të përdoret për rritjen e kapaciteteve dhe për ndjekjen e projektit.

Zhvillimi i kurrikulave nuk kalon nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, pavarësisht se ekziston një koordinim në aspektin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luljeta Dauti – Për sa u përket kurrikulave në rang kombëtar, ato janë kompetenca të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, e cila është tashmë në përgjegjësi të Ministrisë së Financave. Kjo agjenci ka si funksion të saj hartimin e skelet-kurrikulave kombëtare për të gjithë arsimin dhe formimin profesional, skelet-kurrikulat që kanë të bëjnë me të gjitha drejtimet dhe profesionet, si dhe lëndët e profesioneve vazhdon t’i bëjë Agjencia dhe t’i miratojë në Ministrinë e Financave. Kjo bëhet në bashkëpunim me bizneset dhe me të gjithë aktorët e tjerë, pasi nuk i bën agjencia me një person, por ato hartohen me një grup pune në bashkëpunim me biznesit.

Shkollat e arsimit të mesëm profesional kanë skelet-kurrikulat e përgjithshme që i miraton Ministria e Arsimit së bashku me Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe të Formimit Profesional.

Shkaku pse janë përzgjedhur shkolla e Lushnjës dhe ajo e Fierit, është sepse siç dihet, qeveria italiane paraqiti propozimin për të mbështetur fushën e bujqësisë dhe siç dihet, zona e Myzeqesë është zona më e madhe për prodhimin bujqësor dhe të agroturizmit. Për këtë arsye shkollat janë në zonën rurale. Kjo është një arsye shumë e fortë se shkolla nuk është në qytet, por është e vetmja shkollë që është në zonën rurale dhe ofron shkollim në veterinari, bujqësi, dhe tashmë me projektin është në hartim e sipër skelet-kurrikula për agroturizmin, e cila do të jetë një drejtim i ri në fushën e turizmit. Për këtë arsye janë përzgjedhur këto shkolla.

Për sa i përket pjesës së zonës së Krujës, kjo zonë ka një shkollë bujqësore në Durrës, në Golem, të ndërtuar me fondet e buxhetit të shtetit, që tërheq nxënës nga Kruja. Kjo zonë ka, gjithashtu një shkollë për turizmin në Lezhë dhe po ashtu, një shkollë në Shkodër, të cilat tërheqin nxënës nga këto zona. Arsimi profesional është shumë i shtrenjtë. Kemi 13 shkolla, të cilat...

Mimi Kodheli – Është edhe një pyetje tjetër e zonjës Hoxha!

Luljeta Dauti – Për sa i përket sistemit dual, në Shqipëri nuk mund të implementohet sistemi i mirëfilltë dual, siç është në Gjermani apo në Zvicër të cilat janë vende të përparuara, që kanë prej vitesh një sistem të mirëfilltë dual. Në Shqipëri po zhvillojmë elementet e parveqsisë së sistemit dual, të cilat në bashkëpunim me këtë projekt po shihet që të mos jetë projekt që do të mbështesë të dyja shkollat vetëm në fushën e arsimit të mesëm, por do të mbështesin edhe kurset afatshkurtra, ku shkolla do të kthehet në qendra multifunkionale dhe do të ofrojë kurse afatshkurtra që ndjekin *lifelong learning*, pra shkollë për të gjithë jetën. Edhe fermerët mund të trajnohen brenda këtyre shkollave dhe biznesi i zonës mund të marrë studentë për të bërë trajnim nëpërmjet punës. Pra, këto janë elemente të sistemit dual. Prandaj edhe projekti është përfshirë në këtë fushë.

Një nga të rejat që do të sjellë projekti është se do të ketë edhe elemente që do ta fusin sistemin në nivelin 5 të kualifikimeve, i cili është për arsimin pas të shkollës së mesme.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonjë!

Nëse nuk ka më pyetje dhe diskutime të tjera, unë mendoj se meqë kemi përfaqësuesit e Ministrisë së Financave këtu, të kalojmë edhe në prezantimin dhe në diskutimin e projektligjeve të tjera dhe në fund do të kalojmë në votimin e tyre.

Nëse jeni dakord, po kalojmë te diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin

Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”.

Zoti Luçi, fjala për ju!

Erjon Luçi – Faleminderit!

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” nëpërmjet një granti.

Desha të shpreh falënderimet për këtë grant relativisht të madh që është akorduar nga BE-ja për këtë projekt, që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e transportit, sidomos në segmentin Tiranë-Durrës, i cili do të shkurtojë distancën në kohë dhe do ta lehtësojë ngarkesën e trafikut. Them se është një ligj, që plotëson pjesën e grantit. Granti është gati dhe është shumë efektiv si projekt. Shpresojmë që ky projekt të mbyllet brenda 2-3 vjetësh dhe të kemi një farë qëndrueshmërie nga zbatimi në studim.

Mimi Kodheli – Unë kam një pyetje dhe më pas, zonja Gjebrea apo kushdo tjetër kolegj, mund të bëjë pyetje.

T’ju them të drejtën unë nuk e kam parë studimin e fizibilitetit, ndaj edhe mbase pyetja ime është me vend për mua, që nuk e kam parë këtë studim, ndërsa për ju mund të jetë diçka më e thjeshtë. Sa e lidhur është linja hekurudhore Tiranë - Durrës me portin e Durrësit? Pra, që linja të funksionojë jo vetëm si një linjë transporti qytetarësh, por edhe si një linjë transporti mallrash, që presupozohet, duhet dhe shpresoj të zërë një peshë të rëndësishme në këtë projekt. Pyetja mund të duket naive, por shpresoj se ka një peshë specifike.

Zoti Luçi, fjala për ju!

Erjon Luçi – Faleminderit!

I jap fjalën drejtorit të njësisë së zbatimit të projektit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Bashkim Kasoraho – Unë jam drejtori i njësisë së zbatimit të projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës”.

Pyetja juaj është më se e drejtë dhe me shumë peshë, por ky projekt në vetvete nuk e parashikon lidhjen me portin, sepse bëhet fjalë për lidhjen me dy qytetet dhe me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, por gjatë muajit të kaluar ne kemi qenë në marrëdhënie me

Autoritetin Portual të Durrësit dhe është fat i madh që brenda në Portin e Durrësit ka linjë hekurudhore dhe mungon vetëm lidhja që është çështje pak metrash.

Jemi në tratativa dhe kemi një marrëveshje me Portin e Durrësit dhe me Hekurudhën Shqiptare, por që mund ta bëjmë me këtë projekt, i cili ka të bëjë me rehabilitimin e linjës Tiranë-Durrës dhe ndërtimi i linjës së re me aeroportin.

(Diskutime pa mikrofon)

Elona Gjebrea - Faleminderit!

Sigurisht që është një lajm shumë i mirë rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë-Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Unë, si deputete e Tiranës, kam një ndjeshmëri më të lartë lidhur me këtë projekt. Kam një pyetje që ka të bëjë me afatin kohor. Këtu ka disa elemente, të cilat përmenden, si lidhja e linjës së re me terminalin e transportit publik, ndërtimi i terminalit hekurudhor, instalimi i sistemit të ri sinjalizues e të tjera. A ka mundësi të dimë një afat kohor të detajuar në lidhje me këtë?

Faleminderit!

Bashkim Kasaraho – Përveç faktit se kufiri i detajuar është 80 muaj nga fillimi i kontratës, ndërkohë procesi është duke u tenderuar dhe do të përfundojë brenda vitit 2020...

Unë po e ndjek vetë si projekt në aspektin e menaxhimit të hekurudhës. Shpresoj se kjo do t'i japë një mundësi shtyrjeje për të filluar dhe për të krijuar një farë përmirësimi cilësie dhe për të përmirësuar seksionet e tjera, përfshi këtu edhe lidhjen me portin.

(Diskutime pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni - Faleminderit!

Duke qenë se ne e kemi kaluar marrëveshjen edhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, unë doja vetëm t'ju përgëzoja dhe komplementoja. Them se është një nga projektet fituese të Marrëveshjes së Parisit dhe implementimi do të sjellë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të të gjithë zonës Tiranë- Durrës.

Nga sa u prezantua nga zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili tha se projekti është gati dhe brenda vitit do të zgjidhet fituesi dhe të fillojë implementimi, jemi shumë optimistë dhe mbështetës për të, edhe për faktin që ky projekt, përveç rehabilitimit të hekurudhës, ka edhe terminalin e Aeroportit të Rinasit, i cili ka një impakt të jashtëzakonshëm duke shkurtuar kohën për udhëtarët dhe mallrat, por edhe nga ana ekonomike është me shumë leverdi.

Përgëzime dhe suksese!

Mimi Kodheli – Stacioni i trenit. Edhe në Durrës, edhe në Tiranë duhet të ketë një stacion...

Erjon Luçi – Stacioni i trenit do të përfshihet dhe do ta kemi përsëri në këtë tavolinë projektin për ta afruar shumë afër qendrës.

Mimi Kodheli – Unë insistoј se ato pak metra mbeten shumë të rëndësishme, sikur ato metra të ishin edhe një gjysmë metri. Hekurudha ka kuptim kur lidhet dhe unë gjykoј, përtej gjithë parantezës që bëra për pyetjen time naive, që naive nuk është, që ose të përfshihet në projekt, ose nëpërmjet një projekt tjetër ato pak metra të mund të lidhen, se ato pak metra na kanë lënë të mos jemi aty kur duhet të jemi. Për pak metra është çështja, por ndërkohë ne jemi stopuar në një stacion, kur duheј të ishim në një stacion tjetër, në fakt. Metafora besoj se qëndron edhe në këtë rast.

Erjon Luçi – E konfirmoj se ky grant do të bëhet me studim të detajuar për komplet pjesën, ku përfshihet hekurudha dhe kërkesa nga ana ime ka shkuar, pavarësisht se financimi do të jetë ondulluar.

Mimi Kodheli – Dakord.

Nëse nuk ka pyetje të tjera dhe komente, mendoј ta kalojmë edhe këtë projektligj. E mbyllim këtu këtë projektligj me prezantime, pyetje dhe diskutime, në një kohë që votimin e lëmë për në fund të mbledhjes së komisionit.

Kalojmë te projektligji tjetër.

Mimi Kodheli - Urdhëroni, zoti Luçi!

Erjon Luçi - Faleminderit!

Ky është një projekt relativisht i njohur dhe, të paktën nga ana jonë, ka qenë i suksesshëm për rishikimin e formulës së përmirësimit të skemës të ndihmës ekonomike.

Së fundi, një nga objektivat ose fokusi kryesor i kësaj zgjatjeje është pikërisht intensifikimi i punës për sa i përket aftësive të dyzuara, sidomos disa rajoneve, për sa i përket projektit pilot që është duke u bërë në disa njësi të Tiranës.

Komponent kryesor mbetet zgjerimi i skemës për të finalizuar dhe për të përmirësuar edhe mundësinë e riintegrit të familjeve të varfra në tregun e punës. Është rreth 11 milionë dollarë si kredi por përsëri është modeste në krahasim me rëndësinë që ka ky sektor.

Mimi Kodheli – Dakord.

Zoti Luçi, ju falënderoj! Në fakt, kam një pyetje për ju, por edhe një koment për ministrinë e zonjës Kospiri.

Si mendoni për kufirin minimal jetik për ta bërë më të besueshëm dhe më të prekshëm projektin madhor të asistencës?

Erjon Luçi – Ministria mund të ketë një pikëpamje pak më analitike për mënyrën se si ndërtohet ndihma ekonomike dhe ku vendoset formula është një koncept shumë afër minimumit jetik. Pavarësisht mundësive që kemi ne për të rritur apo për ta transferuar, ajo bazohet në variante relativisht analitike, siç janë kaloritë minimale që mund të marrë një person dhe elemente të tjera në aspektin e energjisë apo ujit. Këto ishin elemente të zgjerimit të skemës.

Nëse flasim për një koncept më abstrakt të minimumit jetik, mund ta zgjerojmë pa fund ose të vendosim disa numra që i kam dëgjuar disa herë, por i gjithë diskutimi është rreth justifikimit të atyre minimeve në aspektin e kushteve të jetesës që personat në nevojë kanë dhe deri më tani si skemë është relativisht i arritur.

Një nga objektivat kryesore të këtij programi është pikërisht edhe përmirësimi i mënyrës se si bëhet edhe kompesimi i personave në nevojë, duke pasur një njëfarë tolerance për ata që kanë më shumë nevojë të marrin pak më shumë që të përballojnë jetesën.

Mimi Kodheli – Unë mendoj se kjo pyetje i drejtohet edhe zonjës Kospiri, në një kohë që përtej kësaj desha të dija se pse e keni parë të nevojshme që të mund të përfitoni nga një marrëveshje huaje midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, një projekt i modernizimit të asistencës në një kohë që ju rinovuat një projekt që lidhet me asistencën sociale, pak kohë më parë?

Sa i suksesshëm ishte ky në gjykimin tuaj?

Faleminderit!

Bardhylka Kospiri – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të pyetjes suaj dhe në vijim të prezantimit që bëri zëvendësministri Luçi...

Ka disa mënyra se si referohet ky projekt.

Mimi Kodheli – A i referohemi ne një mënyrë të caktuar, se që ka shumë mënyra unë e di. Problemi është se unë nuk dua të di sa mënyra ka dhe si aplikohen këto në botë, por kur ne do të arrijmë të përcaktojmë këtë dhe pse nuk e bëjmë dot?

Në qoftë se doni që unë të jem më e drejtpërdrejtë me ju, edhe mund të jem..

Bardhylka Kospiri – Kur u hartua projekti i bankës u zgjodh kjo mënyrë, ndërkohë që, nëse do të flasim vetëm për mënyrën sektoriale, probleme që kanë të bëjnë me pagën minimale, sigurimet shoqërore, marrëdhëniet e punës, sigurisht shëndetësore e të tjera. Pra, është shumë e gjerë, por në rastin konkret në kuadrin e këtij projekti nuk përbëjnë pengesë

për mosllogaritjen fiks, sepse referimi është i tillë që ndikon në ndryshimet që sjell kjo në nivelin e varfërisë. Në këto kushte unë mendoj se ky projekt, që ne e zbatuam dhe tani jemi në fazën e mbylljes së fazës së parë, kalojmë në fazën që ndihma ekonomike, pra mbështetja me ndihmë ekonomike të familjeve në nevojë, u fokusua të familjet ekstremisht të varfra.

Lidhur me pikën e dytë, që ju bëtë prezente, në fakt u rishikua, sepse në marrëveshjen e parë të këtij projekti, të vitit 2012, ishte një raport jo i drejtë lidhur me atë që vëmendjen ndaj reformës në lidhje me ndihmën ekonomike dhe reformës për asistencën.

Kështu që kjo reformë ishte parashikuar e lidhur ngushtësisht me pjesën e modernizimit të asistencës, por jo në hapësirën e duhur dhe me suportin e duhur, prandaj u kërkua që të ketë një shtesë, e cila u justifikua sepse ne po pilotojmë me fondin e personave me aftësi të kufizuar. Ka dhënë rezultate të suksesshme dhe duam që ato t'i vazhdojmë më tej për ta shtrirë në të gjithë vendin.

Mimi Kodheli – Edhe një pyetje tjetër. A mendoni se do të ishte më mirë që aplikimi i projektit të modernizimit të asistencës të fillonte me një projekt pilot, në mënyrë që të evitonim çdo lloj dështimi të mundshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardhylka Kospiri - Do ta qartësoj. Ne faktikisht pilotimin e kishim pjesë të projektit. U pilotua 3 vitete e para tek ndihma ekonomike dhe po pilotohet tani me asistencën.

Janë reforma shumë delikate kanë të bëjnë me target grupe shumë të ndjeshme dhe pa marrë rezultatet e pilotimit, kemi bërë përmirësime, kemi bërë ndryshime fushatat e komunikimit, kemi qenë në kontakt me të gjithë target grupet që kemi në fokus për të marrë mendimet, rezultatet. Asistenca na ka mundësuar që të kemi edhe raporte të vlerësimit.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Keni komente të tjera për të shtuar?

Bardhylka Kospiri - Do të thosha vetëm dy fjalë...

Mimi Kodheli – Patjetër! Jeni më shumë se e mirëpritur.

Bardhylka Kospiri - Është shumë interesante dhe duhet të jetë shumë e qartë se do të kemi hapa të tjerë. Duhet të gjithë të përballemi me atë që do të bëjmë në mënyrë që të japë rezultatet. Pra, kjo reformë dhe miratimi i kësaj marrëveshjeje që po bëjmë sot ka si qëllim që të përmirësojë sistemin e barazisë së asistencës sociale. Nëpërmjet këtij sistemi barazie mundësohet nëpërmjet zbatimit të kriterëve të reja për trajtimin e aftësisë së kufizuar në bazë të modelit social.

E dyta, për përmirësimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuar më të cilat merren shërbimet e asistencës sociale gjithashtu dhe harmonizimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përshtatshmërisë për të dyja përfitimet.

Promovimin e tyre social të ekonomike në periudhën tranzitore dhe daljen nga programi i asistencës me pagesë.

Si do të arrihet? Përmirësimi i efikasitetit të mëtijshëm ka të bëjë me hartimin dhe me përdorimin e raporteve të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të automatizuar për menaxhimin e performancës së programeve të asistencës për aftësinë e kufizuar, përmirësimi që po bëhen për studime në programin e asistencës për aftësinë e kufizuar dhe njëkohësisht për këtë janë indikatorët përkatës si në çdo financim shtesë kemi edhe katër indikatorë të qartë dhe të saktë që do të na çojë në përfitim të përfitimin e disbursimit që do të marrim nga huaja.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Nëse nuk ka ndonjë pyetje tjetër apo koment nga kolegët, mendoj ta mbyllim këtu diskutimin për këtë projektligj për të kaluar në projektligjin e fundit. Më pas do të kalojmë në votim, nëse askush nuk është kundër.

Projektligji i fundit që kemi për sot është “Për ratifikimin e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Zonja Kospiri do të largoheni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për të qenë prezent edhe gjatë kohës së votimit që të votojmë në unanimitet projektin tuaj. Pra, jeni më shumë sesa e mirëpritur të qëndroni deri në fund të mbledhjes.

Erjon Luçi - Kjo është një kredi e lidhur me një projekt që është në vazhdim të një projekti shumë të suksesshëm me 400 milionë dollarësh që paguhet më përpara, kryesisht me financimin e Bankës Botërore, por ishte një miks i shumë donatorëve. Pas atij përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale, sidomos me zgjerimin e rrjetit kombëtar ka lindur përsëri nevoja, jo thjesht për vazhdimin e plotësimit të disa nga mangësitë që ekzistojnë ende, sidomos në pjesën e bregdetit ku ka një farë fokus në projektin aktual, por edhe në rritjen e kapaciteteve në nivel lokal të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve rurale dhe lokale. Nëse mund të jap një farë diferencë këtij si projektpërtej investimeve që janë përzgjedhur dhe janë përdorur kriterë relativisht të mira, duke përfshirë edhe prurjet e komunitetit që përzgjidhet dhe lidhjen që ka me turistët sidomos brenda projektit të “100 fshatrave”.

Synimi kryesor është rritja e kapaciteteve sidomos i zonave bregdetare për turistët dhe për të mirëmbjatur sa më mirë cilësinë e shërbimeve të tyre në këtë drejtim. Synimet e projektit janë përtej rehabilitimit të rrugëve rurale, kanë edhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së rrjetit rrugor në nivelin e sigurimit të lokale për sigurimin e transportit në nivelin e qeverive lokale për sigurimin e shërbimit të transportit me një zgjidhje të caktuar.

Përveç kësaj ka edhe një komponent tjetër që është po aq i rëndësishëm sidomos për ne dhe për mbajtjen e TVSH, për monitorimin në kohë gati reale të gjendjes së rrugëve me atë që quhet “*tracking system*”. Ne shpresojmë që së shpejti ta kemi edhe në rrugën kombëtare, është shumë e rëndësishme por edhe në rastin e rrugëve rurale është jashtëzakonisht e rëndësishme për të parë si gjendjen ashtu edhe përdorimin për të pasur një vendimmarrje dhe një mënyrë të shpërndarjes së fondeve në favor të organizuar.

Shuma është 50 milionë me termat standard të Bankës Botërore, 50 milionë dollarë. Kjo do të plotësohet edhe me një shumë të ngjashme së shpejti, sepse 50 milionë mund të jenë përsëri një shumë relativisht e vogël për sa u përket nevojave të rrjeteve kryesore kombëtare.

Ne po mundohemi që projektin e mëparshëm prej kaq milionësh për të plotësuar edhe pjesën e mbetur. Siç e theksova është më tepër te pjesa e kapaciteteve dhe te pjesa e mirëmbajtjes.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Në fakt, do të kisha dashur që në prezantimin tuaj të radhës, ku me të drejtë kërkohen që edhe institucione të tjera financiare mund të ndihmojnë dhe të suportojnë shtesa apo burime të tjera financiare për të pasur një financim më gjithëpërfshirës të projekteve që lidhen me rrugët nacionale dhe lokale, sidomos nga institucione nga ku ju vini dhe drejtoni të mund të kishim një raportim të raporteve që ekzistojnë midis financimeve për rrugët rurale dhe atyre nacionale në Veri dhe në Jug. Sigurisht që kjo ka të bëjë patjetër me politikat e qeverisjes, por ne si anëtarë të parlamentit, si ligjvënës na intereson që për zona të veçanta, pasi gjithsecili prej nesh përfaqëson një zonë të veçantë, përfaqësojmë jo vetëm njerëzit, por interesat atje, zhvillimet, gjithçka që lidhet me zona specifike, mendojmë se mund ta kemi këtë informacion, qoftë ky informacion i organizuar mbi bazë qarqesh, apo pa dashur të vendos vijën ndarëse në lumin Shkumbin, në mënyrë që ne të mund të informohemi për atë që jemi duke folur. Bashkërisht, shpresoj dhe besoj se ndaj të njëjtin opinion se konektiviteti është absolutisht A-ja e zhvillimit, ka disa zona ende në Shqipëri ku investimet kryesore që lidhin rrugët nacionale me qendrat e njëjse administrative, nuk kanë asnjë investim.

Besomëni, e di se për çfarë po flas! Ekziston një rrugë në Shqipëri që lidh pikën doganore, apo kufitare të Qafë Prushit që nuk ekziston një investim jo prej 30 - vjetësh, por as në kohët e mëparshme. Rruga është bërë në kohën e italianëve, që në vitin 1939, për arsye se kjo rrugë në të dyja anët ka miniera. Rruga është shfrytëzuar në mënyrë të padrejtë, në kuptimin që duke qenë se kanë kaluar mjete të rënda, është ezauruar, është konsumuar. Nuk është bërë kurrë një investim i ri, në një kohë që flasim për një rrugë që lidh rrugën kombëtare me një qendër administrative. Për shkak të strukturës dhe relievit të ashpër malor që ka Shqipëria shpeshherë çmimi i ndërtimit të rrugëve tejkalon mesataren, jo vetëm në Ballkan, por edhe më shumë se kaq, por ndërkohë kjo është Shqipëria jonë e dashur dhe ne duhet t'i përshtatemi siç na e ka dhënë Zoti. Mendoj se do të ishte në interesin tonë si parlamentarë që ta kemi jo për t'u bërë bazë diskutimi, as bazë diskriminimi, por për të parë në fund të ditës që ndoshta duhet të konsiderohen disa zona më tepër nga një tjetër. Shqipëria ka turizëm, ecën, lëviz. Kush e ka fatin ta ketë turizmin pranë zhvillohet më shpejt, dikush që mund ta ketë më larg zhvillohet më ngadalë, por gjithsesi konektiviteti i rrugëve rurale dhe lokale mbetet një *must* për zonat e tjera në Shqipëri.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti zëvendësministër, shikoj te relacioni se një pjesë e fondit që do të miratojmë do të shkojë për të forcuar kapacitetet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në dijeninë time Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka vite që operon dhe bën shumë projekte, e mirëkuptoj forcimin e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar projektet, kjo është domosdoshmëri, por çfarë do t'i forcohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit? Cila është shuma që ndahet midis kapaciteteve të bashkive, të cilat kanë shumë nevojë dhe Fondit Shqiptar të zhvillimit?

Mimi Kodheli – Përpara se të përgjigjen zotërinjtë, zonja Gjermani ka një pyetje. Pastaj kolegu Marto ka një pyetje tjetër për zotërinjtë.

Eglantina Gjermani – Edhe unë dua të vlerësoj këtë marrëveshje dhe rëndësinë që ka konektiviteti në të gjithë zhvillimin ekonomik, social dhe të mbështes padyshim atë çfarë tha zonja kryetare më parë lidhur me shpërndarjen gjeografike sa më të drejtë të mundshme për zhvillimin e të gjithë vendit.

Dua të pyes në mënyrë konkrete, se cilat janë bashkitë e përzgjedhura, meqenëse themi që pjesa e parë, vlerësimi i akseueshmërisë do të thotë se përfshihen punimet për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe rurale në bashkitë e përzgjedhura, por ndërkohë në relacion nuk ka informacion se cilat janë bashkitë. Pra, cili ishte kriteri? Nëse flasim për 100 fshatra dhe lidhen rrugët rajonale apo rurale me to, ndoshta, por përderisa nuk është e qartë

doja të dija se cilat janë bashkitë dhe cilat janë kriteret, sepse vërtet jemi të interesuar edhe për t'i ditur, por edhe për të ndjekur zbatimin e tyre në terren.

Mimi Kodheli - Po, zoti Marto.

Andrea Marto - Në fakt kjo ishte pyetje që kisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli- Po, zonja Kushi.

Evis Kushi- Kam një pyetje shumë të shkurtër. A është bërë paraprakisht një studim fizibiliteti? Cilat janë ato rrugë në të cilat duhet të ndërhyhet fillimisht? A ka një studim paraprak?

Mimi Kodheli - Zotërinj të ministrisë, fjalë është për ju.

Ervin Bushati- A ka një studim për këtë studim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli- Ne u ankuam për studimet që nuk funksionojnë siç duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erjon Luçi – Në aspektin e forcimit nuk ka ndonjë efekt të madh. Është pikërisht për menaxhimin që është një sistem për të monitoruar gjendjen dhe përdorimin e rrugëve rurale. Për sa u përket bashkive, do ta nisja nga fizibiliteti; po, është bërë një vlerësim paraprak, përpara sesa të kemi një listë që deri më është kjo.

Evis Kushi – Kush e ka bërë këtë studim?

Erjon Luçi – Është bërë mes FSHZH kriterëve që janë përdorur. Në këtë pikë ka qenë relativisht më e mirë edhe se ajo që është përdorur më parë. Dë të konkretizohen katër projekte, të cilat janë pak më të avancuara dhe do të vazhdojë të plotësohet me propozime e me projekte të tjera, që përmbushin ato kriteret që kërkohen dhe që përmenda më parë, sesa banorë mund të aksesohen.

Një nga projektet është në Fier, Fier - Seman, një tjetër është në Pogradec, Pogradec-Tushemisht, një është në Shkodër, Qafë Thore – Theth, një tjetër është Lezhë – Shëngjin. Lista mund të vazhdojë të zgjerohet, por për momentin janë vetëm këto që përmenda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ju kërkoj ndjesë që po ju ndërpres. Relacioni ka ardhur nga Ministria e

Vasilika Hysi – Jo, është nga Ministria e Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Nëse ka ardhur nga ju, ka një vërejtje shumë të madhe nga ana e kolegëve. Nuk mund të thoni se këto bashki, këto njësi administrative duhet të jenë të përcaktuara dhe të ketë një listë të mirëpërcaktuar nga mbrapa, me emër, zonë, njësi, impakt. Në fakt, ky komision e shikon marrëveshjen nga një pikëpamje tjetër, por kjo nuk do të thotë se na takon ta diskutojmë dhe të hyjmë në këto detaje. Kjo është një vërejtje për ministrinë që ju përfaqësoni. Unë besoj se, nëse herë tjetër do të vijë e tillë, do të kthehet për t'u plotësuar.

Nuk e di nëse kjo që them unë ju duket e drejtë, por e shikoj se është e nevojshme.

Evis Kushi – Ideja është a e kanë apo jo, sepse, me sa dëgjova, është ta kemi në listë dhe pastaj do të shtohet. Domethënë, është e përcaktuar apo është akoma në përmirësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Fjala është për ju, zoti Luçi.

Erjon Luçi – Miratimi i tanishëm është në parim, për sa i përket projektit për zhvillimin e rrugëve rurale, që thashë edhe më përpara, dhe 400 milionshi është modulare por dhe kjo mund të shtohet. Ajo ku ne jemi të fokusuar, ku dhe metodologjia është e mirë.

Mimi Kodheli – Shtyhem nga fakti se këto janë të përzgjedhura.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erjon Luçi – Ka një pikë tjetër te parlamenti dhe komisionet, që është miratimi i buxhetit. Në buxhet kjo listë do të jetë e detajuar. Aty mund të ketë komente apo vërejtje për sa i përket shpërndarjes. Normalisht, për të qenë korrekt është më shumë miratim në parim.

Mimi Kodheli – Termave të marrëveshjes. Jam dakord, por gjithsesi, ne e ruajmë të drejtën për ta pasur, nëse ju e keni, meqë thonë se lista është ndërkohë e përzgjedhur pavarësisht diskutimit që do të bëjmë në buxhet. Mund të mos e kishit thënë se nuk e keni listën gati ose do ta shikonit këtë gjë në buxhet, dhe ne, natyrisht, do të tërhiqeshim nga komentet.

Erjon Luçi – Në fakt, meqë është një projekt relativisht i dëshiruar por në kushte normale...

Mimi Kodheli – Në kushte normale nuk duhej të vinit më këtë listë dhe duhej të vinit me gjëra konkrete.

(Nuk dëgjohej)

Vasilika Hysi – Unë kam diçka, zonja kryetare!

Unë fola shumë, sepse për një pjesë të marrëveshjeve që kemi sot në axhendë, unë kam qenë relatore në Komisionin e Ligjeve.

Komisioni për Politikën e Jashtme vërtet nuk mund ta shohë ligjin në çështje të detajeve, po për sa i përket relacionit, ne kemi disa detyrime edhe në kuadër të rezolutave që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë.

E para, ne themi se do të bëjmë një transparencë të të gjitha nismave ligjore, për t'i parë në zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë vendit, po edhe për të siguruar zhvillimin e të gjithë territorit të Shqipërisë, e jo vetëm si deputetë, siç ju e thatë me shumë të drejtë, zonja kryetare, por edhe në kuadrin e zhvillimit që Shqipëria ka në raport me Ballkanin.

E dyta, kemi miratuar një rezolutë. Është rezoluta “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm”. Ne kemi marrë një angazhim, që për të gjitha projektligjet që do të kalojnë në komision do të ketë një vlerësim të impaktit të tyre social, ekonomik, mjedisor, financiar. Besoj se asnjë ministri nuk mund të bëjë një projektligj gati dhe ta kalojë atë në qeveri pa pasur një studim të tillë.

Në këtë kuadër, do të ishte një rekomandim, megjithëse ne do ta bëjmë këtë edhe në seancë, kur të diskutojmë. E thanë edhe në komisionet e tjera, të cilat ishin për dhënie mendimi, se është mirë që këto të jenë në relacion. E kemi detyrim. Përndryshe do të detyrohemi të dërgojmë shkresa e të përgatisim informacion të detajuar në lidhje me çfarë është bërë në projekt, cili është impakti e të tjera.

Relacionet kanë nevojë të përmirësohen. Ky është projekt kaq i mirë, por një qytetar, i cili akseson këtë projektligj të depozituar në faqen e internetit, nuk mëson asnjë gjë. Nuk mëson as cilat janë bashkitë e përzgjedhura, që ju i keni thënë që në paragrafin e dytë të faqes një te relacionit, as cilat janë bashkitë që do të përfitojnë, as cilat janë kriteret e përzgjedhjes.

Pra, ka nevojë për transparencë, ka nevojë për të matur një impakt, që ne të dimë si ta ushtrojmë kontrollin parlamentar. Është shumë e lehtë të vijmë në parlament e të miratojmë herë pas here qoftë edhe grante, për të cilat s'kemi asnjë detyrim, por të paktën duhet të dimë, duhet të kemi një listë inventar.

Unë pajtohem me atë që tha kryetarja, se ndoshta do të ishte mirë që në një periudhë, të cilën ju do ta gjykonit të nevojshme, të kemi një informacion të detajuar në lidhje me të gjitha investimet që po bëhen, me qëllim që edhe ne të dimë të jemi transparentë me qytetarët.

Pra, jo thjesht të ngremë dorën, por edhe të dimë se ku po investohet.

Faleminderit!

(Nuk dëgjohet)

Erjon Luçi – Është një iniciativë që e kemi bërë publike dhe mund ta aksesoni. Ndërkohë, edhe në nivel qeverie ka disa projekte që janë bërë pikërisht për këtë shpërndarjen aktuale të projekteve.

Vasilika Hysi – Po pse nuk i pasqyroni, kur i keni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Nuk dëgjohet)

Erjon Luçi – Mund t’i jepet njëfarë përparësie...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Nuk dëgjohet)

Vasilika Hysi – Përfitova nga rasti meqë jeni në nivel zëvendësministri dhe na mirëkuptoni.

(Nuk dëgjohet)

Mimi Kodheli – Mirë, zoti Luçi ju falënderoj!

Nëse nuk ka ndonjë koment apo pyetje tjetër, mendoj se duhet të kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1 i projektligjit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2 i projektligjit?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E miratojmë edhe në tërësi projektligjin për asistencën sociale.

Ju faleminderit!

Ju faleminderit Zëvendësministrja Kospiri, që ndenjët për të parë miratimin!

I fundit, jo më pak i rëndësishëm, është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Miratojmë projektligjin.

Neni 1 i projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E miratojmë projektligjin dhe në tërësi.

Ju faleminderit!

Kemi mbyllur kështu për sot mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme.

Ju faleminderit për prezencën, zoti Luçi, zonja Kospiri!

(Mbyllet mbledhja)

MBYLLET MBLEDHJA